

RAPORT NGA KAMPI VEROR PËR FËMIJË ULQINI 2007 NGA DATA 26/08-07/09/2007



Mbështetur dhe financuar nga *ONLUS R.BAZONI*
Implementuar nga *HANDIKOS*

Pjesëmarrësit – Gjithsejt 53

Fëmijë:25

Përcjellëse:23

Ekipi i Handikosit:5



Gjinia e fëmijve:10 vajza dhe 15 djem

Afërsia e përcjellëseve: 20 nëna

02 teze

01 halla

Aftësitë e kufizuara të fëmijëve/Diagnozat:

8 fëmijë me Paralizë Cerebrale

4 fëmijë me Hemiparezë

3 fëmijë me Sy Down

2 fëmijë me RPM

2 fëmijë me LCC

2 fëmijë me Plexus brahialis

1 fëmijë me Hydrocephalus

2 fëmijë me Arthritis

1 fëmijë me Atrophia spinalis

Operimet: Këtë vitë tre fëmijë kanë qenë me operime të ndryshme

Rolet e punëtorëve të ekipit të Handikos-it:

Hatixhe Salihu -Përgjegjëse e kampit dhe kordinatore e aktiviteteve

Arta Marku – Fizioterapeute

Bashkim Selmanaj –Punëtor i rehabilitimit primar fizik

Luljeta Musolli – Edukatore e aktiviteteve zhvillimore/psiko-motorike

Alberita Hylaj – Edukatore e aktiviteteve zhvillimore/psiko-motorike



Transporti: Është bërë nga agjensioni turistik Shpejtimi Tours

Udhëtimi : Nisja nga Prishtina është bërë me datën 23.08.2008 ora e nisjes përafërsisht 20:30,arritja në Ulqin me datën 24.08.2008 në orën 07:30ndërsa nisja e kthimit nga Ulqini me datën 03.09.2008 në orën 19:00 arritja ne Prishtinë me datën 04.09.2008 në orën 05:00



Hapja e kampit– Në mbremjen e parë është bërë hapja dhe prezantimi i qëllimit të kampit 10ditorë,është folur për historikun e kampit,rregullat e kampit si dhe është bërë shpërndarja e parave të gjepit pasiqë disa nga pjesëmarrësit ishin me kushte tejet të vështira ekonomike.

Aktivitetet e mëngjesit:Si qdo vitë tjetër dhe këtë vitë për zhvillimin e aktiviteteve fëmijët janë ndarë në dy grupe në mënyrë që zhvillimi i tyre të bëhet sa më mirë që është e mundur.

Aktivitetet e rehabilitimit fizik (Fizioterapisë) – Është punuar në rehabilitimin primar fizik sikurse në qendrat rehabilituese të Handikos-it gjithashtu dh vetë prindërit janë kyqur në këto aktivitete si terapeut për fëmijët e tyre,kryesisht është punuar në fizioterapi aktive pjesë e aktiviteteve ka qenë gjimnastika grupore me disa prejë fëmijve,autonomia personale e fëmijve,si dhe referencat e ndryshme.

Aktivitetet Psiko-motorike- Në zhvillimin e aktiviteteve psiko-motorike janë përdorur mjete pune si lapsi,gërshërët,plastelina gjatë seancave janë lexuar tregime të ndryshme për fëmijë të marrura nga libra të ndryshme si Fjala Ruhet Kur Shkruhet,Hana Në Karrocën E Saj etj.

Plazhi –Gjatë kohës së plazhit janë mbajtur aktivitetet e lojës:loja e rërës,lojra logjike me topa të ngjyrave të ndryshme,hokej,loja me thasë të rërës,loja e tejkalimit të pengesave,loja me shishe të mbushura,litari,tenisi,futbolli dhe lojra tjer a të improvizuara në ujë pjesë e aktiviteteve të plazhit ka qenë edhe peshkimi i disa fëmijve me fëmijë tjerë që ishin prezent në plazhë,sikurse dhe vitet tjera edhe këtë vitë zt.Ali Kraja ka shprehur dëshirën vullnetare për shpërndarjen e krofneve të cilat u janë shpërndar fëmijve gjdo pas dite.



Vizita në plazhen e madhe- Kjo vizitë është bërë me anije pjesëmarrës kanë qenë të gjithë fëmijët dhe përcjellsit ky ka qenë aktiviteti më atraktivë për fëmijët, lundrimi ka qenë ndjenë shumë e veçantë atmosferë këndimi e buzëqeshja në fytyrat e fëmijëve ka qenë përcjellja e këtij lundrimi.



Shetitja në qytet –Pjesë e shëtitjeve ka qenë edhe vizita në kalanë e Ulqinit me q’rastë fëmijët janë kënaqur duke shikuar pamjet me të bukura nga lartësia e kalasë dhe vetë bukurit e saj. Po ashtu kemi pasur edhe shëtitja të pishat ku qëndronim me orë të tëra pasi që ky vend njihet edhe si rehabilitues për probleme të ndryshme shëndetësore.



Aktivitetet e mbrëmjes –Pjesë e këtyre aktiviteteve kanë qenë hapja solemne e kampit në natën e parë, mbrëmja e vallëzimit, këndimit, nata e maskave, pjesa teatrale nga fëmijët, hapja e ekspozitës së fëmijëve, kuizi me nënat. show i përgatitur nga nënat. Në gjithë këto mbrëmje është vërejtur se fëmijët kanë pasur nevojë për këto aktivitete sepse secila nga to ishte diçka e re e pa shikuar ndonjëherë si për fëmijët ashtu edhe për përcjellsit e tyre. Në mbrëmjen të cilën fëmijët kanë recituar si shpërblim për të gjithë fëmijët ka qenë shpërndarja e dhuratave të cilat janë dhuruar nga pronari i plazhit.



Takimet me prindër: Në kuadër të takimeve është ligjruar për Paralizën Cerebrale, Hemiparezën, sy.doun dhe për diagnozat e tjera të fëmijëve pjesëmarrës, këto takime kanë qenë edhe bashkëbisedime me prindërit pasi që diskutoheshin problemet e fëmijëve dhe si të arrihet deri të sukseset e fëmijëve, shkëmbimi i njohurive ndërmjet vete. Pjesë e takimeve ka qenë edhe takimi informativë mbi formimin e shoqatës Handikos, shërbimet që i ofron brenda dhe jashtë qendrave, të drejtat ligjore të fëmijëve dhe prindërve në këtë takim prezent dhe ligjërues ka qenë menagjeri i regjionit të Prishtinës zt. Bexhet Binaku dhe përgjegjësi i nëndegës në Therandë niherit dhe doktor zt. Rexhep Kuqi.



Kujdesi Shëndetsor :Sa i përket kujdesit shëndetësor është kujdesur dr. Rexhep Kuqi, gjatë këtyre 10 ditëve përveq probleme të zakonshme nuk kemi pasur ndojnë problem me përmasa të mëdha.

Shih tabelën e të dhënave për intervenim:

<i>Dita1</i>	<i>Dita2</i>	<i>Dita3</i>	<i>Dita4</i>	<i>Dita5</i>
1fëmijë/ paracetamol	2fëmijë line- spor	1prind/dexa-neo 2prind/jekoderm 2fëmijë/jekoderm	3fëmijë/line-spor. 1fëmijë/jekoderm 1prind/paracetamol	1fëmijë/mukodin 1fëmijë/albaderm

<i>Dita6</i>	<i>Dita7</i>	<i>Dita8</i>	<i>Dita9</i>	<i>Dita10</i>	<i>Dita11</i>
1fëmijë/line-spor 2prind/albaderm	1prind/paraceta moll 1prind/infuzion 1fëmijë/qepje e varrës(emergjenc ë)	1fëmijë/eferalgan 1prind/albaderm	2fëmijë/paracet amol mukonin 1prind/dexa- neo	1fëmijë/ paraceta moll,muk odin	1fëmijë/muk onin.

Përshtypjet dhe falënderimet:

- Faleminderit për knaqësin që na e dhuroat për kto 10ditë.
- Një falënderim nga zemra.
- Ju dërgojm një puthje sa Kosova.
- Paqe dhe qetsi gjatë gjithë jetës suaj.
- Këto 10ditë kurr nuk do ti harrojmë gjithë jetën do mbesin kujtim në zemrat tona.

Ekipi:

Hatixhe Salihu

Arta Marku

Luljeta Musolli

Alberita Hylaj

Bashkim Selmanaj